

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Këshilli i Sigurimit presion prokurorëve të SPAK? "Çështjet individuale të mos kthehen në krizë besimi nd aj shtetit"
ADRESA	https://lapsi.al/keshilli-i-sigurimit-presion-prokurore-ve-te-spak-ceshtjet-individuale-t-e-mos-kthehen-ne-krize-besimi-ndaj-shtetit-i1094638
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 13:20:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 13:13:53 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	19a73a3022bbc1008c43abbeac8dbb9025b571c4f1f25646272fe3b4724391a2
TEKSTI	eb424197bd5376bb7163e97bfa9d4b1e969bc455b8db0f1ae9d1dc6fea1859ad
PAMJA	5f12acc7193d41852833fc23df31427e514eab8bb6ffc2c3fac8972792a2da4f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c9571838cf30028d7b68438ff71a4c8f4494fabce2997b04bfecf509d29b52cb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c9da2c073e2a83be1965121fd231137d695108173d39514ad5452b64d4c51b05
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c9571838cf30028d7b68438ff71a4c8f4494fabce2997b04bfecf509d29b52cb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Këshilli i Sigurimit presion prokurorëve të SPAK? "Çështjet individuale të mos kthehen në krizë besimi ndaj shtetit"



LAPSI.AL • 28 SEPTEMBER 2026



Këshilli i Sigurimit ka dalë me një deklaratë pas arrestimit të ish-shefes së SHISH, Vlora Hysenit me të cilën i tërheq veshin prokurorëve të SPAK që vepruan pasi gjetën mesazhet në celularin e Ergys Agasit. Bëhet fjalë për mesazhe kompromentuese të Vlora Hysenit e cila sipas SPAK ishte e angazhuar kundër hetimit të Agasit me të cilën ajo ishte në një lidhje.

Pas konferencës së një dite më parë, ku Rama këmbënguli tek prezumimi i pafajësisë së Hysenit, duke e quajtur "ekstreme" masën që u mor ndaj saj, këtë të hënë edhe Këshilli i Sigurimit u vendos në të njëjtën linjë duke u shprehur se:

"Çështjet individuale të mos kthehen në krizë besimi ndaj shtetit dhe ndaj institucioneve të sigurisë".

Nuk kuptohet qartë se çfarë konsideron presidenca "çështje individuale", por në tryezë ishte edhe shefi i SPAK, Klodian Braho, ndërkohë që hetimi për Vlora Hysenin është firmosur nga prokurorët, Altin Dumani dhe Bledar Maksuti.

"Për sigurinë kombëtare, institucionet nuk konkurrojnë me njëri-tjetrin. Ato kanë përgjegjësi të ndryshme, por i shërbejnë të njëjtit interes: sigurisë së Republikës së Shqipërisë. Çdo mosbesim institucional të zëvendësohet me bashkëpunim, koordinim dhe komunikim profesional" u shpreh presidenca në deklaratën përfundimtare.

Me decentralizimin e organeve të drejtësisë që kreu reforma në drejtësi, prokurorët e SPAK kanë pavarësi të plotë në dosjet e tyre hetimore. Në të kaluarën, kjo ka prodhuar përplasje mes drejtuesit të SPAK dhe prokurorëve të tjerë, megjithatë është ende herët për të thënë që Klodian Braho ka marrë përsipër të frenojë vartësit e tij në hetime të

ide



Një histori korruptimi jo dashurimi
Blendi Kajsia



Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm
Andi Bushati

MOTITIRANA

25°C

KËMBIMIEURO

91.97

aktuale

15:00

Rama lan duart me skandalin e SHISH: Çështje individuale e Vlora Hysenit me drejtësisë

22:06



Rama nis sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasia direkt pas kthimit



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



caktuara.

Një ditë më parë në konferencën për mediat, Rama tha se "Këshilli i Sigurisë, thirrur nga Presidenti i Republikës, është vendi i duhur për të reflektuar mbi përgjegjësitë institucionale dhe diskutuar mbi garancitë që duhet t'i mbrojnë institucionet tona, e mbi të gjitha ato të sigurisë kombëtare, kur drejtuesit apo punonjësit e tyre rrëshqasin nga binarët e bëhen subjekt i një hetimi penal".

Ashtu siç pritej, presidenca ka dalë e alarmuar nga Këshilli i Sigurimit, jo për faktin se drejtuesja e SHISH informonte hap pas hapi një person të shpallur në kërkim që akuzohej për grup të strukturuar kriminal, por se prokurorët nxorrën urdhër-arresti për të duke ndalur rrjedhjen e informacionit.

Reagimi i plotë

Tiranë, më 28 shtator 2026

Presidenti i Republikës, Sh. T. Z. Bajram Begaj, thirri sot mbledhjen e Këshillit të Sigurimit Kombëtar për të diskutuar çështjet e aktualitetit dhe impaktin që ato kanë mbi veprimtarinë e institucioneve të sigurisë.

Në mbledhje, përveç anëtarëve që përcakton ligji, ishin të ftuar edhe institucioni e Prokurorisë së Përgjithshme dhe SPAK-u.

Këshilli diskutoi për situatën dhe masat që duhet të merren nga institucionet për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, bashkëpunimin me partnerët dhe aleatët dhe forcimin e besimit të publikut.

Në takim u konkludua se:

Për sigurinë kombëtare, institucionet nuk konkurrojnë me njëri-tjetrin. Ato kanë përgjegjësi të ndryshme, por i shërbejnë të njëjtit interes: sigurisë së Republikës së Shqipërisë. Çdo mosbesim institucional të zëvendësohet me bashkëpunim, koordinim dhe komunikim profesional.

Hetimet e drejtësisë të zhvillohen tërësisht të pavarura dhe të respektohen nga të gjithë. Çështjet individuale të mos kthehen në krizë besimi ndaj shtetit dhe ndaj institucioneve të sigurisë.

Institucionet t'u tregojnë qytetarëve se sistemi di të korrigjojë vetveten e të mbrojë interesin publik. Detyra jonë është të forcojmë standardet, kontrollin, transparencën, llogaridhënien dhe bashkëpunimin institucional.

Shqipëria ka institucione, ka partnerë dhe aleatë ndërkombëtarë, ka profesionistë dhe kapacitete. Institucionet e Republikës të punojnë së bashku për të forcuar shtetin, sigurinë kombëtare dhe besimin e qytetarëve.

Të këshilluara



Përplasje brenda GJKKO-së: Si duhet trajtuar bojkoti i avokatëve

Trupa gjyqësore e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është e...



Tabaku: Shqipëria nuk vuan nga "republika e prokurorëve", por nga republika e të korrupsuarve

Deputetja e Partisë Demokratike kërkon përgjegjësi politike për korrupsionin, transparencë për PPP-të dhe prokurimet, si dhe institucione



Rama sulmon dy televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokurori



Pse nuk bind alibia e kryeministrit "Ileshko", që nuk e dinte për Vlora Hysenin dhe Ergys Agasin



WSJ: Si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të siguronte marrëveshjen 6 miliardë \$ në Shqipëri



Një histori korrupsioni jo dashurimi



Aksidentet rrugore rriten me 6.2% në tetë muaj, më të rrezikshmet Tirana dhe Durrësi



Deklaratë unanime për UÇK-në/ Kuvendi i Kosovës kundërshton Hagën

Kuvendi i ri i Kosovës ka miratuar të hënën, në seancën e tij të parë plenare, një deklaratë lidhur me aktgjy...



Vodhën 6 makina në Kavajë, Durrës dhe Tiranë, në pranga 2 autorët

Dy persona janë vënë në pranga gjatë mbrëmjes së djeshme nga Policia e Kavajës, pasi dyshohet se janë autorët...



Autorët u paraqitën si Taulant Balla: Si u tentua zhvatja e Armand Dukës për 100 mijë euro

Dy të rinj janë arrestuar në kuadër të një operacioni të zhvilluar në Tiranë, pas dyshimeve se kanë tentuar t...



Burimas/ Sherr mes banorëve dhe policisë për ujin e pijshëm, kolapsohet një qytetar




PKD-ja e gatshme të diskutojë për presidentin, nëse kalon projektligji për Specialen

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PKD), Bedri Hamza, ka thënë se nëse miratohet projektligji për ndryshimin dhe plo...



Digjet grumbulli i mbetjeve në Lezhë, flakët rrezikuan disa banesa

Një zjarr ka rënë ditën e sotme në një grumbull mbetjesh në lagjen e Spitalit në Lezhë. Pas kësaj zjarri &eum...



"Armand Duka jam"/ Tentuan t'i zhvasnin 100 mijë euro një 64-vjeçari

Dy të rinj janë vënë në pranga nga Policia e Tiranës, pasi përmes mashtrimit në rrjetet sociale, tentuan të zhvasn...

Me sytë katër



19:19

VIDEO/ Qëllohet me vezë kryeministri hungarez Péter Magyar

Një incident ka ndërprerë fjalimin e kryeministrit hungarez Péter Magyar gjatë një aktiviteti elektorale në qytetin e Szoln...



VIDEO/ Theu derën e supermarketit në Vlorë dhe mori kasën, por u arrestua

17:23



"Më shau, e shava"/ Shefi i komisarit të Krujës flet pas pamjeve të shpullës

21:35



PAMJET/ Protestuesit kapin Bledi Çuçin në kafe, bashkëshortja e tij Delina Fico humb durimin

23:13



VIDEO/ Muriqi feston me bluzën e UÇK-së golin ndaj Irlandës

22:44

SPORT

→ Të tjerë artikuj



13:59

Aedan Scipio, futbollisti me flokët e lidhur në bel: dy lojtarë u përjashtuan se i tërhoqën gërshetat




13:31

Maran humb Caken për San Marinon, dërgon në shtëpi Simonin: Kombëtarja heq dorë nga stërvija zyrtare



13:09

Irlanda mposhti Izraelin brenda e jashtë fushës në ndeshjen e polemikave: koka ulur gjatë himnit, festim për Gazën



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.